



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/109
Datë: 23.11.2022


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me kërkesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës me Nr. Prot.2456 të datës 20.10.2022, jep mendim lidhur me Nismën Legjislative për "Projektligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore", si në vijim:
 - 1.1. Qeveria e Republikës së Kosovës vlerëson se Nisma legjislative nga pika 1 e këtij Vendimi është në pajtim me legjislacionin në fuqi që rregullon këtë fushë, si dhe rregullon më gjerësisht të drejtën dhe detyrimin e institucioneve në lidhje me mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjimore;
 - 1.2. Ministria e Punëve të Brendshme, ofron rekomandime për ndryshimin e neneve të caktuara të nismës legjislative të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi;
 - 1.3. Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, në mendimin e tij për Nismën Legjislative të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, ka konstatuar se nuk është bërë identifikimi i burimeve të financimit në ndarjet tjera buxhetore për mbulimin e kostos shtesë;
 - 1.4. Nisur nga çështjet e lartcekura, Qeveria e Republikës së Kosovës, ofron mendimin e saj që nisma ligjore si e tillë të plotësohet me rekomandimet e dala nga mendimi i Qeverisë.
2. Ky Vendim së bashku me mendimet e institucioneve përkatëse i procedohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/109
Datë: 23.11.2022


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me kërkesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. prot. 2457 të datës 20.10.2022, jep mendim lidhur me Nismën Legjislative për Projektligjin për Rregullat e Trafikut Rrugor, si në vijim:
 - 1.1. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë kanë dhënë rekomandimet e tyre lidhur me nismën e Kuvendit. Qeveria e Republikës së Kosovës konsideron që Kuvendit duhet bazuar në mendimin e dhënë të Qeverisë së Republikës së Kosovës përmes rekomandimeve të ministrive përkatëse;
 - 1.2. Duke pasur parasysh Opinionin e Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve duhet të kihet parasysh që Projektligji 08/L-66 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022 dhe vlerësimet për vitet 2023-2024 nuk parashohin buxhetin e paraparë nga Kuvendi në vlerë prej 3.000.000 euro;
 - 1.3. Opinioni i Përputhshmërisë me Acquis të BE-së potencon që Projektligji për Rregullat e Trafikut Rrugor pjesërisht traspozon dispozitat e acquis së BE-së që rregullojnë fushën ndër-sekrore të trafikut rrugor. Rekomandohet përpilimi i TeP nga institucioni implementues.
2. Nisur nga çështjet e lartcekura, Qeveria e Republikës së Kosovës, ofron mendimin e saj që nisma ligjore si e tillë të plotësohet me rekomandimet e dala nga mendimi i Qeverisë.
3. Ky Vendim së bashku me mendimet e ministrive përkatëse i procedohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/109
Datë: 23.11.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 57 paragrafi 1. të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Shfuqizohet pika 3. dhe 4. e Vendimit Nr.01/02 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për shkak të rrethanave të ndryshuara ligjore.
2. Pagat e sistemit gjyqësor, përfshirë ato të Gjykatës Kushtetuese, kthehen në lartësinë e përcaktuar me rregullimin juridik të mëparshëm.
3. Të gjitha pikat tjera të Vendimit Nr.01/02 të datës 12.02.2020 mbesin të pandryshuara.
4. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/109
Datë: 23.11.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Zyrtarët Publik.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/109

Datë: 23.11.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Pagat në Sektorin Publik.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/109
Datë: 23.11.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë për Programin e Financave Publike dhe Rritjes Ekonomike ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Fondit Opec për Zhvillim Ndërkombëtar.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/109
Datë: 23.11.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L - 060 për Mjekësinë Ligjore.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/109
Datë: 23.11.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore dhe Ministrisë së Mbrojtjes në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me Atashimin e Personelit nga Forca e Sigurisë së Kosovës në Kompaninë Roulment të Këmbësisë në Ishujt Falklands.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/109
Datë: 23.11.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Atashe të Mbrojtjes.
2. Obligohet Ministria e Mbrojtjes dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/109
Datë: 23.11.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Analiza juridike për vlerësimin e bazës ligjore të akteve nënligjore të nxjerra nga Qeveria.
2. Shfuqizohen aktet nënligjore si në vijim:
 - 2.1. Udhëzim Administrativ Nr. 4 mbi zbatimin e Ligjit për Planifikimin Hapësinor mbi Formimin e Këshillit për Planifikimin Hapësinor;
 - 2.2. Udhëzim Administrativ Nr. 5 mbi Zbatimin e Ligjit për Planifikimin Hapësinor për Rregullimin e Mbikëqyrjes të Ndëshkimeve dhe Marrjen e Masave;
 - 2.3. Udhëzim Administrativ Nr. 08/2006 për Masat për Shtimin e Efikasitetit në Administratën Publike;
 - 2.4. Udhëzim Administrativ Nr. 11/2007 për Ndalimin e Përkohshëm të Ndërtimit të Objekteve Brenda Zonave të Mbrojtura;
 - 2.5. Kodi Nr. 01/2007 i Mirësjelljes së Tatimit në Biznese të Kosovës;
 - 2.6. Udhëzim Administrativ Nr. 02/2008 për Caktimin e një Page të të Emëruarve Politikë;
 - 2.7. Udhëzim Administrativ Nr. 10/2008 për Etiketimin e Pajisjeve Elektrike Shtëpiake;
 - 2.8. Udhëzim Administrativ Nr. 11/2008 për zbatimin e Procedurave për Funksionimin e Komisionit për Emërime të Larta Publike;
 - 2.9. Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2010 për Procedurat për Delegimin e Përgjegjësisë për Skemën e Ndihmave Sociale në Nivelin Komunal;
 - 2.10. Udhëzim Administrativ Nr. 01/2011 për Caktimin e Procedurave pas Bartjes së Përgjegjësisë të Shërbimeve Sociale dhe Familjare në Nivelin Komunal;
 - 2.11. Udhëzim Administrativ Nr. 07/2012 mbi Kriteret për Lirimin ose Uljen e Masës Administrative;
 - 2.12. Udhëzim Administrativ Nr. 02/2014 për Regjistrimin dhe Funksionimin e Organizatave Joqeveritare;
 - 2.13. Udhëzim Administrativ Nr. 03/2018 për Gjuhët e Huaja në Programin e Studimit të Ciklit të Dytë apo të Tretë;
 - 2.14. Rregullore Nr. 02/2007 për Krijimin dhe Funksionimin e Grupit të Punës për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Kodit të Mirësjelljes së tatimit në Biznes;
 - 2.15. Rregullore Nr. 01/2010 për themelimin e Zyrës për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat Tjera të Përafërta;

- 2.16. Rregullore Nr. 08/2011 për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Zyrave komunale për Integrim Evropian;
 - 2.17. Rregullore Nr. 14/2012 për Funksionimin e Fondit për Kuadro;
 - 2.18. Rregullore Nr. 20/2012 për Punën Vullnetare të Nëpunësve Civil pas Pensionimit;
 - 2.19. Rregullore Nr. 30/2012 për Kushtet e Kufizimit të së Drejtës për Grevë në Shërbime të Veçanta në Shërbimin Civil;
 - 2.20. Rregullore Nr. 17/2013 për punën e Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror;
 - 2.21. Rregullore Nr. 03/2014 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 14/2012 për Funksionimin e Fondit për Kuadro;
 - 2.22. Rregullore (QRK) Nr. 04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës;
 - 2.23. Rregullore (QRK) Nr. 19/2017 për Mënyrën e Punës dhe Funksionimit të Komisionit Ndërminstor për Investimet Strategjike;
 - 2.24. Rregullore (QRK) Nr. 13/2018 për Procedurën e Rekrutimit të Zyrtarëve Korrektues në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
 - 2.25. Rregullore (QRK) Nr. 18/2014 për Punën e Grupit Punues për Ballafaqim me të Kaluarën dhe Pajtim.
3. Obligohen ministritë që në pajtim me fushën e përgjegjësisë së tyre administrative të iniciojnë procedurën e ndryshimit dhe plotësimit të ligjeve të parapara në këtë Analizë, siç përcaktohen në Shtojcën 2.
 4. Obligohen ministritë që varësisht nga fusha e përgjegjësisë së tyre administrative dhe në pajtim me rekomandimet e dhëna në këtë Analizë, të ndryshojnë dhe plotësojnë aktet nënligjore, siç përcaktohen në Shtojcën 3.
 5. Obligohen ministritë përkatëse që t'i dërgojnë për publikim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në Ueb faqet e tyre zyrtare, aktet nënligjore të cilat nuk janë të publikuara ose nuk është publikuar shfuqizimi i tyre.
 6. Obligohet Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare që të publikojë shfuqizimin e akteve nënligjore sipas pikës 1. të këtij Vendimi në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
 7. Obligohen ministritë që detyrimet nga pika 3. dhe 4. e këtij Vendimi t'i përmbushin brenda një afati prej dymbëdhjetë (12) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij Vendimi.
 8. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit që në bashkëpunim me ministritë përkatëse të koordinojë procesin e implementimit të analizës juridike të miratuar me këtë Vendim.
 9. Pjesë e këtij vendimi janë Shtojcat:
 - 9.1. Shtojca 1 - Analiza juridike për vlerësimin e bazës ligjore të akteve nënligjore të nxjerra nga Qeveria;
 - 9.2. Shtojca 2 - Lista e ligjeve të cilat duhet të ndryshohen dhe plotësohen me qëllim të krijimit të bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore përkatëse;
 - 9.3. Shtojca 3 - Lista e akteve nënligjore që duhet të ndryshohen dhe plotësohen me qëllim të krijimit të bazës specifike ligjore.
 10. Ky vendim hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Sundimi i ligjit është një nga vlerat themelore të rendit kushtetues të Republikës së Kosovës. Në këtë kontekst, parimi i ligjshmërisë së akteve nënligjore në kuptimin e ndalimit të veprimit arbitrar të të gjitha organeve të cilat mund të intervenojnë në marrëdhëniet ndërmjet subjekteve të së drejtës vetëm në bazë të autorizimeve të fituara me ligj, derivon edhe nga Seksioni II, A, 1, 2, 4, i Listës së Kontrollit të Sundimit të Ligjit, të nxjerrë nga Komisioni i Venedikut, ku në mënyrë shprehimore përcaktohet obligimi i institucioneve për të vepruar në pajtueshmëri strikte me kompetencat e përcaktuara me ligj.


Megjithatë, në legjislacionin vendor, parimi i ligjshmërisë së akteve nënligjore (përfshirë epërsinë e ligjit në raport me aktet nënligjore, përputhshmërinë me ligjin, kompetencat ligjore të ekzekutivit si dhe detyrimi për zbatimin e ligjit) dhe parimi i sigurisë juridike (përfshirë qasjen në legjislacion, parashikueshmërinë e legjislacionit dhe pritshmërinë legjitime) është sfiduar nga nxjerrja e një numri të madh të akteve nënligjore pa bazë të mirëfilltë ligjore, rregullimi me akt nënligjor i materieve që në fakt janë kategori ligjore, tejkalimi me akt nënligjor i dispozitave ligjore si dhe mungesa e evidentimit në Gazetën Zyrtare dhe uebfaqet zyrtare, me rastin e nxjerrjes apo shfuqizimit të akteve nënligjore.

Nisur nga këto standarde juridike ndërkombëtare të përcaktuara nga Komisioni i Venedikut në të cilin Republika e Kosovës është shtet anëtar, Qeveria e Kosovës me Vendimin Nr. 02/50 të datës 23.12.2021, veçse ka miratuar analizën e vlerësimit të bazës ligjore të akteve nënligjore të nxjerra nga ministrat, dhe ka shfuqizuar dyqind e nëntëdhjetë e tri (293) akte nënligjore pa bazë ligjore të nxjerra nga ministrat.

Në rrjedhë të kësaj, me qëllim të shqyrtimit të tërësishëm të të gjitha akteve nënligjore, pra edhe të atyre të nxjerra nga Qeveria, sa i përket përputhshmërisë me parimet e sundimit të ligjit sipas Listës së Kontrollit të Sundimit të Ligjit, dhe duke marrë parasysh obligimin që derivon nga pika 2.3.4 e Planit Strategjik dhe Operacional të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit në koordinim me ministratë e linjës dhe me mbështetjen e Qeverisë Gjermane, përmes projektit të GIZ-it "Support to EU Integration Reform Processes in Kosovo", kanë hartuar analizën juridike për vlerësimin e bazës ligjore të treqind e tridhjetë e shtatë (337) akteve nënligjore të nxjerra nga Qeveria.

Rekomandimet e analizës juridike në fjalë lidhur me shfuqizimin, ndryshimin dhe plotësimin e akteve nënligjore dhe ligjeve me qëllim të krijimit të bazës konkrete ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore, të propozuara në këtë vendim, apo në disa raste evidentimi i nxjerrjes apo shfuqizimit të akteve nënligjore në Gazetën Zyrtare dhe uebfaqet zyrtare, janë në funksion të plotë të sigurimit të sundimit të së drejtës, përmes sigurimit të parimit të ligjshmërisë përkatësisht sipas Seksionit II, A, 1, 2, 4, 7 të Listës së Kontrollit të Sundimit të Ligjit dhe parimit të sigurisë juridike sipas Seksionit II, B, 1, 3, 4, 5 të së njëjtës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/109
Datë: 23.11.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave (2022 – 2026), në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Protokolli Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Protokollit sipas pikës 1. të këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/109
Datë: 23.11.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3, të Rregullores Nr.12/2012 për Procedurat e Blerjes dhe Marrjes me Qira të Objektit për Misionet Diplomatike dhe Konsullore të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për fillimin e procedurave për blerjen e objekteve të ambasadave të Republikës së Kosovës në Zagreb/Kroaci dhe Dakar/Senegal.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe institucionet tjera përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi, sipas procedurave të parapara me legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/109
Datë: 23.11.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 42, paragrafi 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 06/L- 114 për Zyrtarët Publik dhe nenit 14 të Rregullores Nr.01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Z. Arsim Tahiri, emërohet Drejtor i Përgjithshëm në Shërbimin Sprovues të Kosovës, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij Vendimi zgjat katër (4) vite.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij Vendimi i kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/109

Datë: 23.11.2022

Në mbështetje të nenit 17, nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafit 5 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi për të kërkuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministres së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për nënshkrimin e Marrëveshjes për Bashkëfinancimin e Bursave të Arsimit të Lartë në Nivel të studimeve Master, ndërmjet Ambasadës së Francës në Prishtinë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.
2. Rekomandohet Presidentja e Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit Ministres së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për nënshkrimin e Marrëveshjes nga pika 1. e këtij Vendimi në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/109
Datë: 23.11.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për negocimin e Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Banka Evropiane për Investime, për Projektin "Rehabilitimi i Linjës Hekurudhore 10-B".
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria Financave, Punës dhe Transfereve obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/109
Datë: 23.11.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për negocimin e Kornizës së Partneritetit ndërmjet Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Qeverisë së Danimarkës e përfaqësuar nga Ministria për Zhvillim dhe Bashkëpunim, për "Bashkëpunim të shtuar për Zhvillim".
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria Financave, Punës dhe Transfereve obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/109
Datë: 23.11.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, të nenit 8, paragrafit 2 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2015 për Përcaktimin e Kostos së Shpenzimeve të Transportit të Mallrave të Importuara, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2022, merr këtë:

V E N D I M


1. Ndryshohet dhe plotësohet vlera e shpenzimeve të transportit detar dhe kontejnerëve në Shtojcën 2. të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2015 për Përcaktimin e Kostos së Shpenzimeve të Transportit të Mallrave të Importuara, konform listës së çmimeve të përditësuara, si pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Dogana e Kosovës për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.17/36 i datës 22.09.2021.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Dogana e Kosovës gjatë vlerësimit, analizës dhe hulumtimeve të bëra ka evidentuar se kostot e shpenzimeve të transportit detar në nivel global të shpenzimeve kanë pësuar rënie të theksuar, kryesisht si rezultat i rënies së vëllimit tregtar. Në këtë drejtim, me qëllim të ndjekjes dhe harmonizimit të çmimeve të transportit detar. Dogana e Kosovës ka rekomanduar rishikimin e shpenzimeve të transportit detar.

Mbi bazën e këtyre vlerësimeve dhe hulumtimeve të kryera nga njësitë e Doganës së Kosovës, dhe mbështetur në nenin 8, paragrafi 2. të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2015 për Përcaktimin e Kostos së Shpenzimeve të Transportit të Mallrave të Importuara u vendos për rishikim të vlerave të shpenzimeve të transportit detar, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

SHTOJCA 2 Tabela e Shpenzimeve të Transportit Detar me Kontejner

Relacioni- Itinerary -			Çmimi sipas llojit të kontejnerit *					
			Price due to container's type *					
			Cena po vrsti kontejnera *					
Shteti State	Porti i nisjes Departure Port		20FT		40FT		45FT	
Zemlja	Loka polaska		USD	Vlera e përditësuar/ ažuriruar vlerdnost	USD	Vlera e përditësuar/ ažuriruar vlerdnost	USD	Vlera e përditësuar/ ažuriruar vlerdnost
Hollandë Netherland Holandija			1067	900	1525	1250	1625	1250
Francë France Francuska			1550	1100	2020	1540	2020	1540
Turqi Turkey Turska	Mersin		1025	615	1132	700	1132	700
Egjipt Egypt Egipat	aleksandri suez		554 1350	1190	720 3536	1700	720 3536	1700
Malta Malta Malta			850	850	1250	1250	1350	1350
Angli England Engleska			1497	1200	2450	2000	2450	2000
Spanjë Spain Španija			1550	1800	2020	2200	2020	2200
Hong-Kong Hong-Kong Hong-Kong			5000	3150	9600	4500	9600	4521
Kina China Kina			8628	3175	12326	5100	12326	5100
Japonia Japan Japan	Fukuyuma		5000	3175	12326	5100	12326	5100
SHBA USA SAD	New York		2100	2800	3100	5600	3400	5600
Koreja e Ju South Korea Južna Koreja	Gwangyang		2820	2600	3948	4200	3948	4500

Liban	Bejrut		620		885		885	
Lebanon				600		900		900
Liban								
Iran			2200		3250		3600	
Iran				2200		3250		3250
Iran								
Tunizi	Rades		750		1100		1200	
Tunisia				1650		2765		2765
Tunis								
Algjeri	Algiers		2840		3692		3692	
Algeria				2000		2953		2953
Alžir								
Tajvan			4070		8300		8300	
Taiwan				3200		6500		6500
Tajvan								
Vietnam	Saigon		5151		9170		9170	
Vietnam				4120		7330		7330
Vijetnam								
India			3500		4900		4900	
Cambodia				2400		3700		3700
Kambodži								
Singapor			6140		8770		8770	
Singapore				3600		5262		5262
Singapur								
Banglades	Chittagong		5331		7620		7620	
Bangladesh				3200		4500		4500
Bangladeš								
Shiri Lanka	Colombo		3323		4748		4800	
Sri Lank				3660		6075		6100
Siri Lanka								
Tailanda	Bangkok		7212		9375		9400	
Tailand				5050		6562		6562
Tajland								
Indonezi	Jakarta		4141		5916		5916	
Indonessia				4200		7250		7250
Indonezija								
Filipine	Manila		5320		7600		7600	
Philiphines				3180		5300		5320
Filipini								
Australi	Sydney		3100		4600		4600	
Australia				3000		3700		3700
Australija								
Kanada	Halifax		2250		3300		3650	
Canada				3300		5600		5600
Kanada								
Portugal	Lisbon		1525		2000		2000	
Portugal				1770		2950		2950
Portugal								
Brazil	Santos		3250		4850		5350	

Brazil			2450		4087		4200
Brazil							
Argjentinë	Bueno Aires	4000		5950		6550	
Argentina			4380		7300		7300
Argentina							
Malajzi	Port Kelang	3825		5479		5479	
Malaysia			3840		6400		6400
Malezija							



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 18/109
Datë: 23.11.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Plani i Zbatimit të Garancisë Rinore konform dokumentit të bashkëngjitur si shtojcë e këtij Vendimi.
2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, organet e tjera ministrore dhe agjencitë e identifikuar në Planin e Zbatimit të Garancisë Rinore për zbatimin e këtij Plani konform kushteve dhe afateve të vendosura në Planin e Zbatimit të Garancisë Rinore.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 19/109
Datë: 23.11.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007, të nenit 14, paragrafit 1. të Ligjit Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve financiare në vlerën prej 500,000.00 € (pesëqind mijë euro) për Organizatat Jo-Qeveritare të cilat ofrojnë shërbime sociale dhe Strehimore sipas Ankesit 1. të këtij Vendimi.
2. Mjetet sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232, nën-programi "Shpenzimet e Paparashikuara" me kod 13100, kategoria e shpenzimeve "Rezerva", dhe transferohen në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve me kod 201, nën-programi "Shpenzimet Bazike për Strehimore" me kod 01500, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Mjetet financiare sipas pikës 1. dhe 2. të këtij Vendimi shfrytëzohen nga OJQ-të dhe Strehimoret për financimin e shërbimeve sociale që ato ofrojnë.
4. Për mjetet financiare të shfrytëzuara nga pika 1. dhe 2. e këtij Vendimi, OJQ-të dhe Strehimoret janë të obliguara të dorëzojnë raporte narrative dhe financiare në Departamentin e Politikave Sociale dhe të Familjes dhe në Divizionin për Buxhet dhe Financa në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.
5. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Mbështetja financiare i ndahet OJQ-ve dhe Strehimore të cilat ofrojnë shërbime sociale, për shkak të kohës së pamjaftueshme për realizimin e procedurave për shpallje të thirrjes publike për mbështetje për vitin 2023, si pasojë e ristrukturimit dhe kalimit të përgjegjësisë të divizioneve të cilat kanë fushëveprim shërbimet sociale nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në Ministrinë e Drejtësisë dhe me qëllim të vazhdimit të punës dhe ofrimit të shërbimeve deri në përfundim të procedurave për shpalljen e thirrjes publike për mbështetjen e OJQ-ve dhe Strehimoreve për vitin 2023.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Ankesi 1

Emri OJQ/Strehimorës	Shuma e mbështetjes financiare
Shpresa dhe Shtëpitë e Fëmijëve Kosovë	22,500 €
Asociacioni for Protection of Rights of Woman and Child - Liria - Gjilan	20,000 €
Shtëpia e Sigurt	20,000 €
Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve Shtëpia Ime - Ferizaj	20,000 €
Center for Protection of Women and Children	20,000 €
Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit të Qenieve Njerzore	20,000 €
Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve - Prizren	20,000 €
Qendra për Mirëqenien e Gruas	20,000 €
Qendra për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijës - Raba Voca	20,000 €
Zenski Inkluzivni Centar	17,500 €
SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë	12,500 €
HANDIKOS - Suharekë, HK-SR	9,000 €
Kosovo Humanitarian and Charitable Society - Mother Theresa, SHHBK	11,000 €
Asociacioni Nacional i Autizmit në Kosovë	11,000 €
Qendra e Kujdesit Ditor - Pema	12,500 €
Kosovar Catholic Church Caritas, C.I.K	11,000 €
Shoqata Down Syndrome Kosova - DSK	11,000 €
Association of Paraplegic and Children Paralysis Persons of Kosovo, HANDIKOS	11,000 €
Qendra Kosovare për Vetë-përkrahje, QKVP	8,500 €
Organizata për fëmijët pa kujdes prindor, OFAP	11,500 €
Shoqata e personave me aftësi të kufizuar, Handikos Ferizaj, Sh.P.A.K.- HK FR	8,500 €

Handikos Pejë, HK - PE	8,500 €
Handikos - Gjilan	8,500 €
Fondacioni Terre des hommes Lausanne në Kosovë	8,500 €
Shoqata për Kujdesin Shtëpiak të të Sëmureve "Duart Plotë Mëshirë", DPM	8,500 €
Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuara të Mitrovicës - Handikos Mitrovica	8,500 €
Shoqata e Paraplegjikve dhe e Paralizës së Fëmijëve, Handikos - Prizren	8,000 €
Shoqata e personave me aftësi të kufizuar, Handikos - Drenas	8,000 €
Autizmi	8,000 €
Independent Women's Association Hareja, Sh.P.G	8,000 €
Qendra për këshillim dhe Rehabilitimin e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Floriani - Skenderaj, QKRFAK - FLORIANI	8,000 €
Shoqata e paraplegjikve dhe e paralizës së fëmijëve, Handikos - Gjakovë	8,000 €
Shoqata e personave me aftësi të kufizuar HANDIFER	8,000 €
Qendra për Përkrahjen e Personave me Aftësi të Kufizuara Mentale, Qendra për Jetë të Pavarur - Q.J.P	8,000 €
Shoqata e të Verbërve të Kosovës - SH.V.K	8,000 €
Klubi Dëshira	8,000 €
Public Organization for Local Initiatives and Supports - Polis	7,500 €
Udruzenje Zena - Povratnica Nas Dom - Novo Brdo, UZP-ND	7,500 €
Shoqata e fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara, HANDIKOS - Vushtri	7,500 €
Këshilli Rinor Rahovecit KRR	7,500 €
Centar za Mir i Toleranciju Pristina, CMTP	7,500 €
Small Development Business Center of Kosovo, S.D.B.C	7,500 €
Shoqata e Personave me Paralizë të Fëmijëve Handicap Kosova	7,500 €
Shoqata humanitare e prindërve me persona me aftësi të kufizuara mendore, HADËR	7,500 €



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 20/109
Datë: 23.11.2022


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-143, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kompensimi financiar i njehershëm për delegatët e legjislaturës 1990 të cilët janë certifikuar me mandatin e deputetit në mbledhjen e Kuvendit të Kosovës të datës 4 dhjetor 1999, të cilët kanë marrë pjesë në Mbledhjen e Kuvendit të Kosovës me datë 3 korrik 1990 dhe me datë 7 shtator 1990 si dhe kanë vazhduar të marrin pjesë në mbledhjet e Kuvendit deri më datë 24 maj 1992.
2. Mjetet financiare të përcaktuara në Ligjin Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-143 në vlerë prej 287,000.00 € (dyqindetëdhjeteshtatë mijë euro) ndahen proporcionalisht sipas numrit të deputetëve konform Gazetës Zyrtare nr. 21 e datës 2 korrik 1990.
3. Për ata deputetë që nuk janë në jetë, kompensimin e plotë financiare të njehershëm, e gëzojnë bashkëshortja/e veja e deputetit apo fëmija deri në moshën 18 vjeçare dhe nëse janë në studime deri në moshën 26 vjeçar, sikurse përcaktuar në pikën dy (2) të këtij Vendimi.
4. Dokumenti në bazë të cilit vërtetohet numri dhe identiteti i deputeteve që gëzojnë kompensimin financiar të njehershëm, sipas pikës 1. (një) të këtij Vendimi është Gazeta Zyrtare nr. 21 e datës 3 korrik 1990.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi, obligohet Ministria e Financave, e Punës dhe Transfereve.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë